

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika AnchorFix®-2+

ADEZIV ANKORIMI PËR NGARKESA MESATARE DERI NË TË LARTA

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Adeziv ankorimi me 2 përbërës, me bazë epoksidi-akrilati, pa tretës dhe stiren për ankorime në kushte klimatike normale/ të moderuara.

PËRDORIMET

Sika AnchorFix®-2+ duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Si një adeziv ankorimi me tharje të shpejtë për:

- Shufra / çelik për përforcim
- Shufra të filetuara
- Bulona dhe sisteme të posaçme mbërthimi
- Beton (te plasaritur ose jo)
- Mure solide
- Çelik
- Gur natyror i fortë*
- Gur solid*

* Këto nënshtresa mund të variojnë shumë, sidomos për sa i përket rezistencës, përbërjes dhe porozitetit. Prandaj dhe duhet të testohet në çdo aplikim përshtatshmëria e adezivit Sika AnchorFix®-2+ duke e aplikuar produktin vetëm mbi një zonë për provë. Kontrolloni në veçanti rezistencën, njolloshjen e sipërfaqes dhe çngjyrosjen.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Tharje e shpejtë
- Mund të përdoren pistoletat standarde
- Kapacitet i lartë për mbartje ngarkese
- ETA sipas ETAG 001 për ankorim mbi beton
- ETA sipas ETAG 001 për lidhjet e shufrave
- I përshtatshëm për betonin e plasaritur
- Certifikuar për ujin e pijshëm
- Disponohet certifikate LEED
- Nuk varet, edhe në aplikime tavanore
- Pa stiren
- Me pak aromë
- Firo e ulët

MIRATIME / STANDARDE

- Ankorazh i ngjitur me metodën e injektimit sipas ETAG 001 Pjesa 1 dhe 5 Opsioni 1, ETA-14/0346, Deklaratë Performance 020205010020000011 5034408 (1138), certifikuar nga organi i njoftuar i certifikimit të produktit 1020, certifikata e qëndrueshmërisë së performancës 1020-CPR-090-032534 dhe mbart markën CE.
- Shufra të post-instaluar sipas ETAG 001 Pjesa 1 dhe 5 TR 023, ETA-13/0779, Deklaratë Performance 020205010020000011 5034408 (1138), certifikuar nga organi i njoftuar i certifikimit të produktit 1020, certifikata e qëndrueshmërisë së performancës 1020-CPD-090-036698 dhe mbart markën CE.
- Certifikatë për ujin e pijshëm: Water Regulations Advisory Scheme Ltd. (WRAS) Numër miratimi: 1604543

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	tubetë standarde 300 ml	12 copë/ kuti
		75 kuti/ paletë
Ngjyra	Përbërësi A: e bardhë Përbërësi B: e zezë Përbërësit A+B të përzierë: gri	
Jetëgjatësia	15 muaj nga data e prodhimit Të gjitha tubetat Sika AnchorFix®-2+ kanë të printuar mbi etiketë datën e skadencës.	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia	~1.62–1.70 kg/l (përbërësi A) ~1.44–1.50 kg/l (përbërësi B) ~1.60–1.68 kg/l (përbërësit A+B të përzierë)	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	~70 N/mm ² (7 ditë, +20 °C)	(ASTM D 695)
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	~7 000 N/mm ² (7 ditë, +20 °C)	(ASTM D 695)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	~29 N/mm ² (7 ditë, +20 °C)	(ASTM D 790)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~15 N/mm ² (7 ditë, +20 °C)	(ASTM D 638)
Moduli i elasticitetit në tërheqje	~3 800 N/mm ² (7 ditë, +20 °C)	(ASTM D 638)
Temperatura e funksionimit	Afatgjatë Afatshkurtër (1-2 orë)	-40 °C min. / +50 °C max +80 °C (ETAG 001, pjesa 5)

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Për detaje projektimi, ju lutemi referohuni tek dokumentacioni që ofrohet: Dokumentacioni teknik Sika AnchorFix®-2+ 870 43 06
-----------------------------	--

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përbërësi A : përbërësi B = 10 : 1 për vëllim
Trashësia e shtresës	~5 mm max.
Rrjedha e varjes	Nuk varet, edhe në aplikime tavanore
Temperatura e produktit	Sika AnchorFix®-2+ duhet të jetë në temperaturë midis +5°C dhe +30°C për aplikimin.
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +30 °C max.
Pika e vesës	Kujdes kondensimin. Temperatura e nënshtresës gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës.
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +30 °C max.

	- T _{gel}	
+25 °C – +30 °C	4 minuta	40 minuta
+20 °C – +25 °C	5 minuta	50 minuta
+15 °C – +20 °C	6 minuta	75 minuta
+10 °C – +15 °C	8 minuta	85 minuta
+5 °C – +10 °C*	10 minuta	145 minuta

*Temperatura min. e tubetës = +5 °C


UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS


Llaçi dhe betoni duhet të kënë moshë më të madhe se 28 ditë. Duhet të verifikohet rezistenca e nënshtresës (beton, mur, gur natyror). Duhet të kryhen testime tërheqjeje (pull-out) nëse nuk dihet rezistenca e nënshtresës. Bira e ankorimit duhet të jetë gjithnjë e pastër, e thatë, pa vaj dhe graso, etj. Grimcat e lira duhet të hiqen nga birat. Shufrat e filetuara dhe hekurat duhet të pastrohen plotësisht nga vaji, grasoja apo nga çdo lloj substancë dhe grimca si pislëku etj.

PËRZIERJA


Përgatitja e tubetës: 300 ml




1. Zhvidhosni kapakun



2. Pritni shiritin




3. Vidhosni përzierësin statik




4. Vendosni tubetën në pistoletë dhe filloni aplikimin

METODA E APLIKIMIT / MJETET


Ankorime në mure solide / beton:




Shpuni birën me një trapan elektrik në diametrin dhe thellësinë e kërkuar. Diametri i birës së hapur duhet të përputhet me përmasat e ankorimit.




Bira e shpuar duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Bira e shpuar duhet të pastrohet tërësisht me një furçë hekuri të posaçme (pastroni të paktën 2x). Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së shpuar.




Bira e shpuar duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Bira e shpuar duhet të pastrohet tërësisht me një furçë hekuri të posaçme (pastroni të paktën 2x). Diametri i furçës duhet të jetë më i madh se diametri i birës së shpuar.




Bira e shpuar duhet të pastrohet me një pompë fryrjeje ose me kompresor ajri, duke filluar nga fundi i birës. (të paktën 2x)
Kujdes: përdorni kompresorë pa vaj!




Pomponi rreth dy herë derisa të dy përbërësit të dalin në mënyrë uniforme. Mos e përdorni këtë material që sapo doli. Lironi presionin e pistoletës dhe pastroni majën e tubetës me një copë.



Injektoni adezivin brenda birës, duke filluar nga fundi, ndërsa tërhiqni ngadalë prapa përzierësin statik. Në çdo rast shmangni hyrjen e ajrit. Për bira të thella mund të përdoret tub zgjatimi.



Futni ankorimin me lëvizje rrotulluese brenda birës së mbushur. Një sasi e vogël adezivi duhet të dalë jashtë birës. Kujdes: ankorimi duhet të vendoset brënda kohës së punueshmërisë.



Ndërkohë që rrëshira forcohet ankorimi nuk duhet të lëvizet apo t'i vendoset ngarkesë përsipër. Pastroni menjëherë veglat me Sika® Colma. Shpëlani mirë duart dhe lëkurën me ujë të ngrohtë dhe sapun.

DOKUMENTA SHITESË

Për detajet e projektimit, ju lutemi referohuni tek dokumentacioni që ofrohet:
Dokumentacioni teknik Sika AnchorFix®-2+ 870 43 06

Sika Albania SHPK
Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika AnchorFix®-2+
Maj 2019, Botimi 01.01
020205010020000011

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t'i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaAnchorFix-2+sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf